



Të ofrojmë një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh financiare, veçanërisht për popullatën që jeton në zonat rurale të Shqipërisë me qëllim rritjen e përfshirjes financiare dhe zbutjen e varfërisë.

SHKK LIDER NË ZONAT RURALE

- Pozicionuar fuqishëm në tregun e mikrofinancës;
- Kudo pranë anëtarëve me kanale fizike e online, edhe në zonat më të largëta;
- Norma më të mira interesi për kredi dhe depozita;
- Model unik i qeverisjes, me anëtarin në qendër;
- Shërbime financiare dhe jo-financiare;
- Shërbime të reja të digjitalizuara;
- Edukim financiar e digjital, konsulencë e ekspertizë për anëtarët;
- Anëtarësi gjithëpërfshirëse: urbane, rurale, individë, biznese mikro dhe SME.



FED INVEST ME NJË VËSHTRIM



60 DEGË

Akses digjital për shërbime financiare dhe jo financiare në mbarë vendin.



254 TË PUNËSUAR

Në shërbim të anëtarëve, shpërndarë në 64 zyra në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

74.867



Anëtarë janë pjesë e familjes sonë FED invest. Ata janë aseti ynë më i rëndësishëm.



89.9% VLERËSIMI
i Kënaqësisë të Punonjësve



% JANË FEMRA
53% e Punonjësve
35% e Anëtarëve
57% e Manaxhimit të lartë



PERFORMANCA FINANCIARE 2020



Rritje 6%
në vitin e
raportimit

6.2

MILIARDË LEKË
TOTALI I AKTIVEVE



4.4

MILIARDË LEKË
KREDI



19.5%

MJAFTUESHMËRIA
e KAPITALIT



4.4

MILIARDË LEKË
DEPOZITA



PËRMBAJTJE

1	MESAZH NGA KRYETARJA E KËSHILLIT DREJTUES	4
2	QEVERISJA E SHKK FED invest	5
3	FUQIZIMI I MARKËS FED invest	6
4	RRITJE E QËNDRUESHME E BIZNESIT	7
5	28 VITE PROGRES I PANDALSHËM	14
6	OBJEKTIVAT PËR 2021	15
7	MOTIVIMI I STAFIT DHE RRIJTJA E KAPACITETEVE NJERËZORE	16
8	SHËRBBIME TË REJA FINANCIARE PËR ANËTARËT	17
9	QENDRA ABA	18
10	PARTNERËT STRATEGJIKË	20
11	PASQYRAT FINANCIARE	24
12	RAPORTI I AUDITORIT TË JASHTËM	25
13	RRITEMI BASHKË ME ANËTARËT	27

MESAZH NGA KRYETARJA E KËSHILLIT DREJTUES

Të nderuar lexues,

Ndjehem e privilegjuar që, në emër të Këshillit Drejtues, t'ju paraqes Raportin Vjetor 2020 të FED invest, duke uruar që ju dhe familjet tuaja të keni kaluar sa më qetë e me shëndet këtë situatë pandemie.

Sfidat me të cilat u ndeshën këtë vit ekonomitë, familjet e institucionet financiare, si dhe pasojat e tyre socio-ekonomike, ishin të jashtëzakonshme dhe nuk mund të zgjidheshin absolutisht me qasje standarde.

Falë përpjekjeve afatgjata në ndërtimin e themeleve të sigurta të qeverisjes institucionale, pozicionimin strategjik, ruajtjen e niveleve të larta të likuiditetit, kapitalizimit dhe cilësisë së aktiveve, FED invest arriti të reagojë shpejt dhe të përshtasë me sukses produkte e shërbime në ndihmë të anëtarësisë, ruajti ritmin e aktivitetit, duke operuar çdo ditë në të gjitha degët dhe forcuar më tej besimin e anëtarësisë.

Investimet afatgjata në kapacitetet njerëzore, proceset dhe teknologjinë bankare vërtetuan se ishin të duhurat. Pas implementimit me sukses të sistemit të ri FlexCube, ekipi punoi intensivisht për të realizuar punën në distancë dhe mundësuar kryerjen në kohë të transaksioneve dhe sigurinë e sistemeve. FED invest veproi shpejt edhe në marrjen e masave të sigurisë në zyra, zbatimin e sistemit të rotacionit, ofrimin e një serie trajnimesh për stafin, pajisjen me tableta dhe laptop të personelit etj.

Kultura "Anëtari në Qendër" e instaluar në çdo njësi të FED invest dhe roli i tij i veçantë në përfshirjen financiare siguruan një bashkëveprim të suksesshëm të ekipit, në qendër e degë, me anëtarësinë, duke mbetur një partner i besuar dhe promotor i rritjes ekonomike edhe në periudhat më të vështira për vendin.

Në kuadrin e projektit FIAS ne prezantuam këtë vit Qendrën e Asistencës Agri dhe platformën interaktive, ABA online, me synim ofrimin e shërbimeve jo-financiare për fermerët në mbarë vendin, si dhe zbatuam Skemën Pilot të Mbështetjes me inpute bujqësore për 250 fermerë të vegjël të goditur nga pandemia.

Në mënyrë të veçantë, dua të falenderoj sinqerisht partnerët tanë strategjikë për besimin e vazhdueshëm dhe mbështetjen e pakursyer në këtë periudhë sfidash. Falë punës, angazhimit dhe besnikërisë së secilit, sot pas nesh qëndron një vit financiar i suksesshëm.

Ndaj në emër të Këshillit Drejtues, do të doja t'ju shprehja përgëzimet e konsideratën e lartë të zgjedhurve, stafit dhe ekipit të manaxhimit, për përkushtimin, përgjegjshmërinë e nivelin e lartë të profesionalizmit.

Besimplotë për një zhvillim të qëndrueshëm e afatgjatë të institucionit,

Sinqerisht,

Zana Konini

Kryetare e Këshillit Drejtues të SHKK FED invest



Zana KONINI


Kryetare e Këshillit Drejtues të SHKK FED invest



Kultura "Anëtari në Qendër" e instaluar në çdo njësi të FED invest dhe roli i tij i veçantë në përfshirjen financiare siguruan një bashkëveprim të suksesshëm të ekipit, në qendër e degë, me anëtarësinë, duke mbetur një partner i besuar dhe promotor i rritjes ekonomike edhe në periudhat më të vështira për vendin.



QEVERISJA E SHKK FED INVEST



Punimet e Asamblesë së VII-të në platformën ABA ONLINE www.abaonline.al

Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues, duke vlerësuar specifikat e situatës së pandemisë dhe i ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e përmbushjes së pritjeve të anëtarësisë, përshtati politikat e drejtimit, duke përcaktuar disa prioritete kryesore, si mbrojtja e shëndetit të stafit dhe anëtarësisë, adaptimi i shërbimeve për anëtarët, ruajtja e performancës financiare, forcimi i partneriteteve strategjike, etj.

Bashkëveprimi i shkëlqyer me manaxhimin e FED invest, bëri të mundur mbylljen e një viti financiar të suksesshëm.



Nga e majta në të djathtë Zj. Merita Cani, Z. Drini Salko, Zj. Zana Konini, Kryetare, Z. Valentin Gocaj, Zj. Lindita Lati-Milo.

Asambleja e Përgjithshme e vitit 2020 ishte Asambleja e VII-të e FED invest. Në kushtet e pandemisë u mundësua për herë të parë zhvillimi i saj online.

Asambleja miratoi raportet e aktivitetit dhe pasqyrat financiare, si dhe mori vendime të rëndësishme për zhvillimin e FED invest.

Ndër të tjera, kjo Asamble zgjodhi dy komitete të reja, atë të "Qendrës ABA" dhe "Anëtari në Qendër".

Komiteti Kontrollit


Komiteti i Kontrollit si organi më i lartë monitorues i FED invest ka realizuar mbikëqyrjen e veprimeve financiare të kryera në periudhën midis dy Asambleve.

Gjithashtu, ky Komitet ka ushtruar kontrolle mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së shoqërisë, bazuar në aktet ligjore e nënligjore të saj. Në kushtet specifike të pandemisë, Komiteti i Kontrollit ia doli që një pjesë të veprimtarisë së tij ta realizojë online përgjatë vitit 2020.



Nga e majta në të djathtë Zj. Haxhire Demirxhiu, Kryetare, Z. Flamur Rroshi, Zj. Lefteri Liçka.

QEVERISJA E SHKK FED INVEST II



Komiteti "Anëtari në Qendër"

Përfshirja e anëtarësisë në vendimmarrje.



Komiteti "Qendra ABA"

Filozofia "Anëtari në Qendër"

Nxitje

- Nxitje e të gjitha hallkave për maksimizimin e cilësisë së shërbimeve ndaj anëtarit;
- Zbatimi i një metodologjie uniforme dhe konsistente komunikimi me anëtarësinë.

Përfshirje

- Anëtarësi besnike;
- Promovim të produkteve dhe shërbimeve financiare dhe jo financiare;
- Edukim Financiar;
- Edukim Digjital.

Fuqizim

- Një kanal komunikimi për përcjelljen e vlerave të markës tek stafi, të zgjedhurit dhe anëtarësia;
- Mbështetje e Manaxhimit në forcimin e "Markës FED invest" dhe e fushatave të marketingut për promovimin e Qendrës dhe Platformës ABA;
- Rritja e shkallës së kënaqësisë të anëtarëve në FED invest.

Përkushtim

- Suport i vazhdueshëm për shërbimet ndaj anëtarëve;
- Përmirësimi i proceseve të ofrimit të shërbimit;
- Asistencë e personalizuar për anëtarët e rinj;
- Ndërveprim dhe aktivizim i anëtarëve.

Edukimi Financiar i Anëtarësisë,

- një nga shtyllat e filozofisë sonë "Anëtari në Qendër".
Prandaj jemi të angazhuar për të fuqizuar anëtarin me njohuri financiare, nëpërmjet aktiviteteve dhe materialeve të ndryshme të edukimit financiar si: manaxhimi i parasë, procesi i kredimarrjes, internet banking etj.



FUQIZIMI I MARKËS FED invest

- 1** Rinovimi sipas standarteve bashkëkohore të degës historike në Gjinar të Elbasanit;
- 2** Rikonceptimi i faqes www.fedinvest.al si një platformë interaktive për anëtarët dhe klientët, e orientuar në informacione për anëtarin dhe mundësi aplikimi online;
- 3** Komunikimi, informimi dhe suporti i anëtarëve dhe i komunitetit nëpërmjet kanaleve sociale;
- 4** Ngritja e Njesisë së Kujdesit të Klientit, si kanal i domosdoshëm ndërlidhjeje me anëtarët dhe mbështetjeje për shërbimin e FED Online;
- 5** Takime rajonale mbi kulturën, vlerat dhe misionin e FED invest me punonjësit, të zgjedhurit dhe anëtarët;
- 6** Materiale të larmishme dhe video tutoriale mbi edukimin financiar dhe digjital;
- 7** Anketime të vazhdueshme me anëtarët për përmirësimin dhe përshtatjen e të gjitha shërbimeve në FED invest;
- 8** Takime dhe prezantime të historive të suksesit të anëtarëve të FED invest;
- 9** Informimi dhe komunikimi i rregullt me aktorët e zinxhirit të vlerës mbi të rejat më të fundit në bujqësi nëpërmjet revistës ABA Online.





PRIORITETET MADHORE GJATË VITIT ISHIN:

- Ruajtja e shëndetit të stafit dhe anëtarëve;
- Shërbim i përkushtuar për të gjithë anëtarët;
- Ruajtja e qëndrueshmërisë financiare;
- Forcim i marrëdhënieve me partnerët.

- ✓ Zbatuam me rigorozitet masat e sigurisë për parandalimin e përhapjes së virusit;
- ✓ Mbajtëm degët hapur dhe vazhduam t'ju shërbenim anëtarëve edhe në ditët më të vështira;
- ✓ Intensifikuam komunikimin e hapur dhe të ngushtë me klientët për të dëgjuar shqetësimet dhe kërkesat e tyre;
- ✓ Ristrukturuam 10% të kredive aktive në një afat rekord prej dy muaj, duke përshtatur këstin, periudhën grace, afatin e kredisë dhe lehtësira të tjera sipas kapacitetit të kredimarrësve;
- ✓ Prezantuam skemën pilot të mbështetjes me inpute për fermerë të vegjël, bazuar në studimin e nevojave të tyre në kushtet e pandemisë.

PROJEKTI FIAS - SKEMA PILOT E INPUTEVE BUJQËSORE



PËRFSHIRJA
FINANCIARE
E FAMILJEVE
TË VOGLA SHQIPTARË
FIAS

- Nga zbatimi i kësaj skeme përfituan gjithësej 250 fermerë;
- Skema ishte në vijimësi të mbështetjes së vazhdueshme të FED invest ndaj anëtarëve në vite, si për shëmbull për dëmet e shkaktuara nga përmbytjet, nga tërmeti i nëntorit 2019, nga efektet e thella të pandemisë në 2020.

[250]
FERMERË PËRFITUES
INPUTE BUJQËSORE

Vlerësimi i fermerëve përfitues për skemën:



"Ishte një ndihmë e shkëlqyer dhe e vërtetë"

"Ishte hera e parë që e përfitova"

"Një ndihmë shumë e dobishme, në kohë dhe e vlefshme për ne fermerët në këto ditë të vështira"

"Unë jam i kënaqur sepse askush tjetër nuk më ofroi mbështetje"

"Shumë faleminderit dhe ju uroj suksese!"




ARRITJA E OBJEKTIVAVE DHE PERFORMANCA E AKTIVITETIT NË KUSHTET E PANDEMISË




- Rritja e portofolit të kredive dhe depozitave;
- Ruajtja e një cilësie të mirë të portofolit;
- Rikthimi në aktivitetin e kredihënies si në kushtet para pandemisë;
- Monitorimi i dedikuar i kredive të ristrukturuara për shkak të COVID-19 dhe reagimi i shpejtë për shqetësimet dhe kërkesat e klientëve;
- Forcimi i qëndrueshmërisë financiare.

Kthimi nga kapitali




Portofoli me probleme dhe rezervat për humbjen



ARRITJA E OBJEKTIVAVE DHE PERFORMANCËS SË AKTIVITETIT NË KUSHTET E PANDEMISË II




Sektorët e Financuar




Portofoli i Kredisë

Shuma në milionë Lekë



Numri i Anëtarëve




Portofoli i Kredisë

- Totali i portofolit të kredisë është 4.38 miliardë Lekë për 13,065 kredimarrës aktivë;
- Portofoli i kredisë është rritur me 5% krahasuar me vitin 2019;
- 4,724 kredi të disbursuara;
- Kredia mesatare e disbursuar 425.7 mijë Lekë.

Portofoli i Depozitave


Shuma në milionë Lekë



Portofoli i Depozitave

- Portofoli i depozitave arriti shifrën 4.35 miliardë Lekë;
- Stabilitet dhe rritje e lehtë nga viti i kaluar;
- Depozitat me afat 36-mujor përbëjnë peshën kryesore në portofol.

28 VITE PROGRES I PANDALSHËM



1992-2020 Zgjerim, konsolidim, transformim dhe partneritete strategjike. Banka Botërore, FIDES, Credit Mutuel, SDC, ICO, Rabo Bank, EFSE DF, JICA, EIF, RCFG.

2016

- ▶ Licencimi nga Banka e Shqipërisë së SHKK "FED invest" - dt. 03.02.2016
- ▶ Ligji i ri për SHKK-të dhe Unionet e tyre.
- ▶ Miratimi nga Banka e Shqipërisë mbi licencimin dhe veprimtarinë e SHKK-ve.
- ▶ Miratimi i Kodi Etik dhe i Sjelljes.
- ▶ Nënshkrimi i marrëveshjes me Qeverinë Hollandeze, EFSE DF, RIAS dhe FED invest.

2017

- ▶ Përfshirja në skemën kombëtare të sigurimit të depozitave.
- ▶ Miratimi i Statutit të FED invest nga Asambleja e Përgjithshme.
- ▶ Miratimi i "Kodit të Qeverisjes të FED invest."
- ▶ Nënshkrimi i projektit me JICA dhe Qeverinë Shqiptare për përfshirjen financiare të fermave familjare.
- ▶ Marrëveshja e parë e garancisë me EIF.

2018

- ▶ Miratimi i Kuadrit të brendshëm të Manaxhimit të Riskut.
- ▶ Nënshkrimi i marrëveshjes me Ministrinë e Bujqësisë - Skema IPARD II.
- ▶ Certifikimi nga BE i Kodit të Sjelljes me Klientin.
- ▶ Miratimi i Kuadrit Rregullativ për Vijueshmërinë e Biznesit.
- ▶ Miratimi i Rregullores së Monitorimit të Kënaqësisë së Klientit.

2019

- ▶ Miratimi i Manualit të ri të Financës.
- ▶ Përditësimi i Rregullores të shqyrtimit të Ankesave.
- ▶ Miratimi i kuadrit Rregullativ dhe Politikave të sigurisë së IT.
- ▶ Përditësimi i "Rregullores të Depozitave" dhe "Manualit të Kredisë."
- ▶ Nënshkrimi i marrëveshjes së parë për borxhin e varur me Helenos Fund.

2020

- ▶ Licencimi i aktivitetit të pagesave nga Banka e Shqipërisë.
- ▶ Hartimi i Procedurave të reja operacionale në përputhje me sistemin e ri të TIK.
- ▶ Miratimi i Paketës së Emergjencës për Përballimin e Pandemisë.
- ▶ Miratimi i Rregullores së re të Manaxhimit të Rrezikut të SHKK-ve dhe Unioneve të tyre nga BSH.
- ▶ Zgjerimi i Fondit të garancisë me EIF.
- ▶ Marrëveshja e borxhit të varur me EIF.
- ▶ Miratimi i Kuadrit Rregullativ të Llogarive Rrjedhëse.
- ▶ Miratimi i Rregullores së ALCOs dhe Rregullores së PPPFT.

OBJEKTIVAT PËR VITIN 2021

Të nderuar lexues,

Kemi lënë pas një vit të jashtëzakonshëm me sfida dhe vështirësi të mëdha dhe të paparashikuara. Falë angazhimit dhe përkushtimit të të gjitha strukturave të FED invest, që nga Këshilli Drejtues, stafi, anëtarët e të zgjedhurit, ne arritëm jo vetëm ta përballojmë situatën e pandemisë, por të bëhemi akoma më të fortë, të rritemi dhe të shtyjme përpara planet tona për të ardhmen dhe nismat me partnerët strategjikë. FED invest demonstroi qëndrueshmëri financiare, operacionale dhe manaxheriale për të përballuar sfidat aktuale. Qasja dhe investimet e kryera gjatë viteve të fundit në drejtim të digjitalizimit na ndihmuan në përballimin më lehtë të efekteve të pandemisë.

Në përbushje të misionit tonë, në vitin 2021 do të bëjmë realitet ofrimin e disa prej shërbimeve të reja financiare dhe jo financiare për anëtarët, të cilat janë pjesë e objektivave strategjike të FED invest:

▶ **Shërbimi i pagesave utilitare** do të ofrohet në të gjitha degët e FED invest, fillimisht për pagesat e energjisë elektrike dhe më pas edhe për pagesa të tjera utilitare. Shërbimi do të ofrohet sidomos në zona rurale që nuk kanë alternativa të tjera.

▶ **Shërbimi i internet banking, FED Online** do jetë i aksesueshëm për të gjithë anëtarët e FED invest në të gjithë Shqipërinë, duke mundësuar pagesat midis anëtarëve në kohë reale.

▶ **Platforma aboonline.al dhe aplikacionet respektive** për të gjithë telefonat smart, me një gamë të gjerë të shërbimeve jo-financiare do të ofrohen për të gjithë fermerët shqiptarë.

Krahas objektivave të mësipërme, gjatë vitit 2021 ne do të synojmë forcimin dhe rritjen e të gjithë aktivitetit:

- rritja e portofolit të kredisë dhe depozitave;
- diversifikimi i gamës së produkteve e shërbimeve financiare dhe zgjerimi i rrjetit të degëve;
- fuqizimi i markës FED invest dhe rritja e aktivitetit nëpërmjet optimizimit të kanaleve digjitale dhe nismave të CRM-së;
- forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve njerëzore dhe teknologjike dhe përshpejtimi i zbatimit të nismave digjitale të shërbimeve financiare dhe jo-financiare;
- konsolidimi i pozicionit financiar dhe i qëndrueshmërisë institucionale;
- zgjerimi i partneriteteve strategjike;
- fillimi i zbatimit të projektit "Dritarja Digjitale" në degët kryesore të FED invest, me synim edukimin financiar dhe digjital të anëtarëve.

Frymëzuar nga besimi i anëtarëve tanë në këto tre dekada, ne rritemi dhe fuqizohemi bashkë me ta!


Sinqerisht,

Perlat SULAJ
Administrator i SHKK FED invest



PERLAT SULAJ
Administrator i SHKK FED invest

▶▶ FED invest demonstroi qëndrueshmëri financiare, operacionale dhe manaxheriale për të përballuar sfidat aktuale. ▶▶



ANGAZHIMI I PUNONJËSVE, MOTORI I FORCËS SË FED INVEST NË KËTË VIT PANDEMIE



30
REKRUTIME
+ PROMOVIME

30 Rekrutime dhe promovime

Vazhduam rekrutimet e reja dhe ofrimin e një sërë programesh të trajnimeve për rritjen profesionale të stafit përfshirë këtu: trajnimet për sistemin e ri, produktin e llogarisë rrjedhëse, shitjet dhe shërbimin e klientit, internet banking, edukimin financiar, shërbimet e Qendrës ABA etj.



89.9%
VLERËSIMI I KËNAQËSISË
SË PUNONJËSVE

“Kënaqësia e punonjësve” është në fokus të manaxhimit të FED invest dhe veçanërisht të Departamentit të Burimeve Njerëzore, të cilët realizuan anketimin e të gjithë stafit gjatë 3-mujorit të dytë të këtij viti. Në këtë anketim morrën pjesë **89.9%** e stafit të FED invest dhe rezultati i agreguar i Indeksit të Kënaqësisë ishte **8.95** kundrejt **8.41** të vitit paraardhës.



- Përkushtim, dedikim, sakrificë e stafit në ditët më të vështira të pandemisë;
- Vazhdimi pa ndërprerje, në asnjë moment, i kontakteve me anëtarin, duke respektuar me rigorozitet masat e mbrojtjes;
- Të hapur për t'u përshtatur me sistemet e rotacionit në zyrë e degë dhe punën në distancë;
- Të hapur për të mësuar teknikat dhe teknologjitë e reja dhe adoptuar takime, shërbime dhe trajnime në mjedisin online;
- Rritje e nivelit të kënaqësisë së punonjësve edhe pse në një vit të pazakontë.



ZHVILLIMET TEKNOLOGJIKE

ORACLE®
FLEXCUBE

U kurorëzua me sukses dalja LIVE në **29 Janar 2020** me sistemin e ri bankar **Oracle Flexcube** në një hark kohor prej një viti. Një projekt madhor që angazhoi të gjitha strukturat dhe stafin e FED invest me mbështetjen e konsulentëve të **JICAs** dhe ekspertëve të **Rabobank**.

Kalimi në këtë sistem të ri bankar u realizua duke migruar të dhënat e anëtarëve nga sistemi i vjetër, duke mos e ndërprerë aktivitetin e FED invest.

Ky sistem mundëson të gjitha produktet e shërbimit bankar dhe rrit efektivitetin dhe eficientësinë e manaxhimit të portofolit dhe të operacioneve të degëve, duke rritur gamën e produkteve dhe shërbimeve për anëtarësinë tonë.

LANÇIMI I PRODUKTEVE TË REJA

► Llogaria rrjedhëse Korrik 2020

Duke hapur një llogari rrjedhëse në FED invest, anëtarët mund të administrojnë më mirë të ardhurat e tyre, të paguajnë këstet e kredisë, të kryejnë pagesa të ndryshme nga një llogari në tjetrën dhe nga një anëtar në tjetrin.

► Internet Banking – FED online


Implementimi i Digital Banking nëpërmjet platformës FED Online ju siguron anëtarëve:

- Informacion mbi kontratat e depozitave me afat dhe të kursimeve, kredive dhe transaksioneve në llogaritë rrjedhëse;
- Kryerjen e transfertave të brendshme midis llogarive të të njëjtit anëtar dhe midis llogarive të anëtarëve të ndryshëm;
- Shkarkimin e të gjithë informacionit lidhur me transaksionet në llogaritë rrjedhëse.

FED Online plotëson të gjitha kushtet e sigurisë së informacionit duke respektuar të gjitha standardet e sigurisë online.


► Fillimi i implementimit të shërbimit për Pagesat Utilitare

Nënshkrimi i Marrëveshjes midis FED invest dhe FSHU - Furnizuesi i Shërbimit Universal për të kryer pagesat utilitare të energjisë elektrike të anëtarëve tanë në degët e FED invest.



FSHU OSHEE GROUP
FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

QENDRA ABA ZËRI I FERMERËVE SHQIPTARË




Qendra ABA ofron informacion, ekspertizë, edukim, mundësi për krijimin e lidhjeve dhe rritjen e kapacitetit të biznesit. Shërbimet e Qendrës ABA vijnë në kohë reale për të gjithë fermerët shqiptarë në platformën digjitale ABA Online.

Qendra ABA mundëson:

- Informacione mbi teknologjinë e prodhimit për fermerët në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë;
- Trajnime dhe Demonstrime Praktike në Terren;
- Seminare për të ndihmuar fermerët dhe sipërmarrjet agri në çdo fazë të biznesit të tyre;
- Informacione mbi inputet bujqësore, çertifikimet bujqësore dhe standartet për eksport;
- Aktivitete për lidhjen e aktorëve të zinxhirit të vlerave.

Qendra ABA për t'ju përgjigjur nevojave të fermerëve shqiptarë për zhvillimin e kapacitetit të biznesit të tyre ka përzgjedhur një Ekip Ekspertësh, të cilët përgatisin informacione objektive, bashkëkohore dhe të besueshme sipas fushave kryesore të bujqësisë dhe blegtorisë në vend:

- Fermat Blegtorale;
- Perimet e Serrave;
- Perimet e Fushës;
- Pemët Frutore & Vreshtat;
- Ulliri & Agrumet;
- Bletaria.



www.abaonline.al

ÇFARË ËSHTË PLATFORMA ABA ONLINE

ABA Online është një platformë digjitale që ofron informacione dhe shërbime të personalizuar në sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë, për të përmbushur nevojat e çdo fermeri shqiptar, me qëllim zhvillimin e biznesit dhe të aftësiwe financiare.

Çfarë ofron platforma ABA Online?

Të gjitha aktivitetet dhe shërbimet në Qendrën ABA synojnë rritjen e kapaciteteve të fermave bujqësore e blegtorale. Platforma ABA online mundëson aksesin e këtyre shërbimeve në kohë reale nga çdo fermer në mbarë vendin:

- Informacione mbi teknologjitë e prodhimit, lëndët e para, plehurat kimike dhe organike, pesticidet, çmimet e tregut, standardet për eksport apo çertifikimet bujqësore;
- Promovimi i skemave mbështetëse;
- Edukim financiar, si dhe promovimin e praktikave më të mira në bujqësi e blegtori;
- Krijimin e kontakteve dhe partneriteteve mes fermerëve, tregut dhe partnerëve të zinxhirit të vlerës;
- Promovimin e historive të suksesit të fermerëve dhe fermave bujqësore;
- Ekspertizë nga specialistë të mirënjohur në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.



Arritjet e Qendrës ABA në fund të vitit 2020:



2,665 përdorues të regjistruar



92 abonentë të regjistruar në Revistën ABA



99 artikuj të specializuar sipas fushave të caktuara nga ekspertët



4 numra të Revistës ABA



4 Video të realizuara mbi shërbimet dhe regjistrimin në platformën ABA online

PROJEKTI FIAS: PËRFSHIRJA FINANCIARE E FERMAVE TË VOGLA FAMILJARE



PERFESHIRJA
FINANCIARE
E FAMILJEVE
TE VOGLA SHOQIPTARE
FIAS



DËGJIMI

KULTURË E ORIENTUAR TEK ANËTARI

- Transformimi organizativ me fokus anëtarin
- Përgjigja ndaj COVID 19 me Skemën e Mbështetjes me inpute bujqësore

FUQIZIMI

NDËRTIMI I KAPACITETEVE

- Edukim financiar & digjital
- Ekspertizë teknike Agri & info mbi tregun nga shërbimet e Qendrës ABA

AKSESI

MUNDËSIMI I AFTËSIVE TEKNIKE

- Modernizimi i infrastrukturës së IT për t'ju përgjigjur nevojave të anëtarëve dhe zgjeruar aksesin në financë
- Shërbime digjitale agri dhe informacione teknike dhe mbi tregun përmes platformës ABA online



PROJEKTI "PËRMIRËSIMI DHE ZGJERIMI I SHËRBIMEVE FINANCIARE, ME QËLLIM ZHVILLIMIN EKONOMIK TË SHQIPËRISË RURALE"



- Suport për implementimin me sukses e standarte sigurie të sistemit Flexcube, shërbimit të internet banking, FED Online & rritja e sigurisë së IT-së.
- Drejt ndërtimit të modeleve të zinxhirit të vlerës.
- Nisma të guximshme digjitale në funksion të një shërbimi më të mirë të anëtarësisë.
- Fuqizimi i markës FED invest dhe aktivizimi i kanaleve digjitale të komunikimit me anëtarët.
- Mbështetje për analizën e riskut të Kredisë dhe atij Operacional, Manaxhimin e Likuiditetit dhe KPI-ve.
- Pjesëmarrje në Programin e Lidershipit të Rabobank.



Panelist në webinarin e Institucioneve të Kooperativave Financiare dhe Impakti i Covidit, aktivitet i Bankës Botërore dhe Rabobank.



ME PARTNERËT STRATEGJIKË PËRBALLOJMË SFIDAT DËSHMI NGA PARTNERËT



HARUKO KAMEI

Znj. Haruko Kamei: Drejtore e Zyrës për Barazinë Gjinore dhe Uljen e Varfërisë, JICA.

“Të gjithë ne duhet të jemi shumë krenarë për progresin e arritur vitin e kaluar në mes COVID-19 nga FED invest dhe ekipi i FiAS. Përgëzoj të gjitha përpjekjet e bëra nga FED invest për të mbajtur gjallë shërbimin e mbështetur fermerët e vegjël edhe në një situatë kaq të vështirë. Ne do vazhdojmë të punojmë së bashku për tejkalimin e situatës së krizës dhe arritjen e objektivave të projektit për të mbështetur fermerët e vegjël në Shqipëri”.



TOMOMI UCHIKAWA

Drejtore pranë Zyrës për Barazinë Gjinore dhe Zvogëlimin e Varfërisë, Selia e JICAs, Tokio.

“Jam e mahnitur nga eventit i lançimit të Qendrës ABA dhe rezultatet e arritura nga Skema e Parë e Mbështetjes së inputeve, e cila ka tërhequr edhe vëmendjen e CGAP”.



TOM GRUINTJES

Manaxher Projekti për Rabo Partnerships

“Partneriteti me FED invest ka treguar larmishmërinë dhe potencialin e zhvillimit të zonave rurale nëpërmjet sistemit të kooperativës financiare. Institucioni është transformuar me një temp kaq të fuqishëm në këto vite, aq sa jam me të vërtetë i entuziazuar dhe i nderuar të punoj me ekipin e shkëlqyer të FED invest”.



BJORN SCHRIJVER

Drejtor Projekti, Rabobank

“Rrugëtimi i FED invest është i mrekullueshëm nga disa këndvështrime. Duke qëndruar besnik dhe i vërtetë ndaj misionit të financës sociale, brenda pak viteve, Institucioni arriti të konsolidojë rrjetin e segmentuar të SHKK-ve në Shqipëri, rriti ndjeshëm portofolin e kredisë rurale dhe njëkohësisht fuqinë e vet financiare. FED invest u rrit profesionalisht, u kompjuterizua dhe tashmë po zhvillon një shumëllojshmëri shërbimesh të digjitalizuara për të përmbushur kërkesat e nevojat e klientëve. Duke përfaqësuar Partneritetin e Rabobank, ne jemi të nderuar dhe krenarë të jemi pjesë e këtij udhëtimi ngazëllyes të FED invest, në të tashmen dhe në të ardhmen”.



Rabobank



VENERA HOXHA

Përgjegjëse për Investimet “Financa në Veprim” / Finance in Motion, Këshilltare e EFSE dhe Anëtare e Komitetit Drejtues të Projektit.

“FED invest është një partner strategjik për EFSE mënyra unike e themelimit të tij, si dhe rrjeti i krijuar e bëjnë atë një kanal ideal për zgjerimin e përfshirjes financiare të popullsisë rurale të Shqipërisë, sidomos në sektorin kyç të agrikulturës. Dëshirojmë të mbështesim veprimtarinë e fermerëve të vegjël por gjithashtu edhe sipërmarrje të tjera mikro dhe të vogla në zonat rurale për të investuar në të ardhmen e tyre”.



ME PARTNERËT STRATEGJIKË PËRBALLOJME SFIDAT II

ZHVILLIMI I MËTEJSHËM I PARTNERITETEVE STRATEGJIKE FINANCIARE



3 MILIONË EURO

Marrëveshje kredie me një afat 4-vjeçar të nënshkruar me EFSE.

2 MILIONË EURO

Miratim nga Komiteti i Investimeve të EIF-së për dhënie të borxhit të varur në 2021.



NGA 30 DERI NË 70 MILIONË EURO

Zgjerimin e garancisë së dhënë nga EIF, sipas programit të EaSi, për një portofol të kredisë deri në 70 milionë Euro, me qëllim mbulimin më të shpejtë të efekteve të pandemisë.

HELENOS

Miratimi i kredisë me Helenos Fund si borxh i varur dhe pjesë e kapitalit të FED invest.



Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania
T +355 4 22 74 632
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al
contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për Këshillin Drejtues të FED invest

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë së Kursim Kreditit FED invest ("Organizata"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2020, pasqyrën të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e fluksveve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ligjin nr. 52 datë 19 maj 2016 "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre".

Baza për Opinimin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionalistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Etikës për Kontabilistët (IESBA), kërkesat e cila janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me ligjin shqiptar "Mbi kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe ligjin nr. 52 datë 19 maj 2016 "Për Shoqëritë e Kursim-Kreditit dhe Unionet e tyre", dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë entitetin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të entitetit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivtë tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedurë auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontroleve të brendshme.
- Marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedurë të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontroleve të brendshme të entitetit.
- Vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Konkludojmë mbi përdorimin e duhur të parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojmë që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënie e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brendshëm të cilat ne identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
21 prill 2021

Klodian Doda, FCA



Grant Thornton
Sh.p.k.
NIPT
K 91923007 M
Tirana
ALBANIA
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D, Shk. B, Floor 1, 10 000

PASQYRAT FINANCIARE

Më 31 Dhjetor 2020

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Aktivitet	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Mjete Monetare	268 201	337 193
Depozita me afat	914 992	877 519
Letra me Vlerë	212 241	110 439
Interesa Pjesëmarrës	718	718
Kredi	4 203 082	3 980 476
Aktive afatgjata materiale	455 267	492 097
Aktive afatgjata jomateriale	82 795	75 578
Aktive të tjera	149 984	119 686
Aktivitet totale	6 287 280	5 993 706

Detyrimet

Hua	961 584	966 906
Detyrime të qirasë	4 042	4 937
Fond për rezervë statistikore	45 750	83 967
Depozita të anëtarëve	4 459 728	4 269 585
Detyrime të tjera	65 615	60 407
Grante të shytyra	93 036	101 441
Borxh i varur	62 005	61 030
Totali i Detyrimeve	5 691 760	5 548 273

Kapitali

Kapitali	148 127	145 732
Rezervat	299 701	259 942
Teprica e mbartur	147 692	39 759
Totali i kapitalit	595 520	445 433

Totali i kapitalit dhe detyrimeve	6 287 280	5 993 706
--	------------------	------------------

Më 31 Dhjetor 2020

(në mijë lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Të ardhura nga interesat	661 939	555 636
Shpenzime për interesa	(91 829)	(86 444)
Të ardhura neto nga interesi	570 110	469 192
Shpenzime nga zhvlerësimi i huave, neto	51 826	(44 253)
Të ardhura neto pas zhvlerësimit të huave	51 826	(44 253)

Të ardhura nga komisionet, neto	47 079	68 623
Të ardhura neto nga komisionet	47 079	68 623

Të ardhura nga investimet	12 079	15 074
Të ardhura nga shitja e portofolit të kredive të fshira	-	26 479
Shpenzime interesi per huatë	(29 063)	(25 635)
Të ardhura jo-operative neto	13 326	6 359
Të ardhura të tjera neto	-3 658	22 277

Shpenzime personeli	(297 243)	(281 942)
Shpenzime administrative	(159 241)	(160 455)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(51 413)	(24 906)
Shpenzime për ASD	(9 768)	(8 777)
Totali i shpenzimeve	(517 665)	(476 080)

Rezultati Financiar Neto	147 692	39 759
--------------------------	---------	--------



TIRANA

UNAZA E RE
PAZARI I RI
PETRELË
BARZEË
KASHAR
VORË
KAMËZ
MARIKAJ
ZALLHERR
SAUK
TIRANA E RE
21 DHJETORI
DISTRICT OF
RURAL
TIRANA

KORÇË

KORÇË
BILISHT

POGRADEC

POGRADEC
ÇERRAVE

LIBRAZHD

LIBRAZHD
PËRRENJAS

GRAMSH

ELBASAN

ELBASAN
MOLLAS
GJINAR
BELSH
CËRRIK
KUQAN

PEQIN

VLORË

VLORË
RRUGA E RE
HIMARË
SKELE
ORIKUM
NOVOSELË

SARANDË

FIER

VAJKAN
LEVAN
FIER
SVA
FIER 2
DAULLAS

LUSHNJE

KËMISHTAJ
LUSHNJE
REMAS
KRUTJE
ÇERMË
DIVJAKË
BUBULLIMË

SHKODËR

SHKODËR
BUSHAT

KOPLIK

LEZHË

PËRMET

DURRËS

DURRËS
SHIJAK
MANËZ

BERAT

BERAT
URA VAJGURORE
KUÇOVË

KAVAJË

GJIROKASTËR

KUKËS

LAÇ

RRITEMI BASHKË ME ANËTARËT



Ardjan Lulaj
Rritës dhe tregtar
(Bimë medicinale)
Malësi e Madhe, Shkodër
Klient SME



Krenar Sula
Tregtar Agro-Biznes
(Blegtori, Serra)
Goriçan, Berat
Klient SME



Vlash Ndreca
Fermer i vogël
(Pemë frutore/Vreshtari)
Troshan, Lezhë
Klient Mikro 1



“Partneritet dhe bashkëpunim serioz me FED invest ndër vite.”

Teksa vizitojmë plantacionet me bimë medicinale në Malësinë e Madhe, surprizohemi me angazhimin serioz të kësaj zone për të kultivuar bimë medicinale autoktone. Z. Ardjan Lulaj, është kultivuesi më i madh në zonë. Ka mbaruar studimet e larta për biokimi dhe gjithashtu jep mësim në këtë fushë. Z. Ardjan tregon se falë mbështetjes së FED invest ndër vite, ka filluar të investohet fuqishëm në industrinë e bimëve medicinale, me rritjen e kërkesave për këto bimë. Fillimisht ai kultivoi 1 ha sherebelë dhe me kërkesën e tregut sot ka shtuar aktivitetin me dhjetra hektarë tokë. Për të shtuar sasinë e kultivuar Z. Ardjan tregon se gjithashtu bleu fidanë të Bregut Dalmat si dhe fara angleze dhe sllovene për këto bimë medicinale, por cilësia e sherebelës nuk ishte e njëjta me atë vendase. “Fara jonë autoktone jep prodhim bio, me aromë kumbuese dhe me vlera kurative të jashtëzakonshme”.



“Ky vend ku jeton, mirësinë ta shton.”

Është e vërtetë se Oficeri i Kredisë u bë “shkas” dhe e nxiti që të investonte për zgjerimin e serrave. Madje i vëllai ka investuar në serra me ngrohje për fidane, sepse kërkesa ishte shumë e madhe, rrefen ai. Z. Krenar Sula rrëfen se nga puna e tij ka pesë dynym serra, ku sera diellore gjatë viteve të fundit ka patur vërtet sukses, duke gjeneruar më shumë të ardhura për familjen Sula. Për të përmirësuar dhe për të rritur kapacitetet, Krenari i është drejtuar disa herë FED invest-it, për të aplikuar për kredi. Investimi në serra diellore sot vazhdon me shlyerje të rregullta nga Krenari. Për më tej ai ka krijuar eksperiencë jo vetëm në zbatimin e teknologjisë së domates, të kastravecit, specit, por shpesh fermerët e zonës e pyesin dhe për informacione në lidhje me hibridet, që përdor dhe teknologjinë. Tani kam qingja e dele dhe e kam zgjeruar edhe me viça, të cilët janë më fitimprurës në prag festash, pasi ka shumë kërkesë në treg”



“Faleminderit për besimin FED invest!”

Si fermer inovator, Z. Vlashi ka prezantuar në zonë një teknikë të re për shartimin e filizave të rinj për pemët. Agronomët e zonës përdorin dyll blete për zënien e filizave, kurse teknika greke përdor qiriun. Aplikimi i kësaj teknike ka dhënë rezultatet e pritshme të suksesshme dhe Vlashi krenohet me të drejtë. Një vlerësim i veçantë nga Vlashi shprehet edhe për ABA online, pasi përditësimi me zhvillimet më të fundit në sektorin e pemëtarisë dhe vreshtarisë në vend është një informacion i dobishëm. Aktualisht Vlashi prodhon për konsum vetjak edhe reçel, raki apo verë. Me ngritjen e vreshtit të ri, Vlashi është optimist se tregtimi i rrrshit organik do të jetë një sipërmarrje e suksesshme. Puna e tij e palodhshme dhe aktiviteti bujqësor i suksesshëm janë një vlerë e shtuar edhe për zonën.

 www.fedinvest.al
www.abaonline.al

 [fedinvest.al](https://www.facebook.com/fedinvest.al)
[qendraaba](https://www.facebook.com/qendraaba)

 [Fed Invest](https://www.linkedin.com/company/fedinvest)

 [Fed Invest](https://www.youtube.com/channel/UC...)
[Qendra Aba](https://www.youtube.com/channel/UC...)

 FED online
<https://www.ebank.fedinvest.al>



 Kujdesi ndaj anëtarit
069 70 60 000
kontakte@fedinvest.al



Skano

